

Koncerti përmban një repertor të larmishëm të këngës napolitane. Prezantohen muzika klasike dhe ajo me tradita kombëtare



Instituti Italian i Kulturës në vendin tonë nis sezonin artistik me koncertin me titull "Serenata Napoletana", me pjesëmarrjen e këngëtarit të njohur Pietro Quirino dhe "Quartetto Calace". Koncerti do të zhvillohet në datën 26 janar në skenën e Akademisë së Arteve. Nga Instituti i Kulturës mësohet se ky grup i jashtëzakonshëm artistësh ka bashkëpunuar me interpretuesit më të mëdhenj të muzikës italiane dhe ndërkombëtare. Me anë të koncertit "Serenata Napoletana" propozohet një itinerar historik mjaft i detajuar i këngës napolitane, i cili ndjek një linjë shumë filozofike. Programi është mjaft i artikuluar, ekzekutimi është i një niveli shumë të lartë. Prezantohen nga muzika klasike më pas vijon me traditën kombëtare, duke arritur tek kënga autorit, në këtë mënyrë ndiqet një vijimësi historike-muzikore, që e ka fillimin e saj rreth viteve 600 për të mbërritur deri në mesin e viteve 900, duke sjellë lloje të ndryshme të muzikës napolitane, por në të njëjtën kohë duke respektuar natyrën e teksteve të ekzekutuara.

Performanca është perfekte. E konceptuar dhe duke ruajtur me shumë besnikëri traditën, nëpërmjet një studimi të thellë të teksteve ndjehet bashkimi i tyre në zërat e instrumenteve të interpretuara në skenë (mandolina, mandol, kitarë, vegla popullore etj, dhe mbi teknikat ekzekutive, duke sjellë ritmet e humbura me zërat melankolik, duke realizuar një spektakël të çmuar me një linjë të hollë elegance. Teatri madhështor, që grupi performon gjatë spektaklit vjen si një thirrje e ndjenjës poetike, që është e pranishme në çdo këngë dhe vjen dukshëm dhe me delikatesë nga elementët historik të pranishëm në çdo tekst. Veçanërisht dominues është zëri i mrekullueshëm, por gjithmonë i ndërthurur me teknikën e stilin në të kënduar të epokave, i cili vjen fuqishëm, kjo si fryt i një kulture dhe historike që flet në emër të shpirtit të përjetshëm. Ndërkohë që Instituti Italian i Kulturës në vendin tonë ka disa vite që zhvillon aktivitetin e tij. Ai daton në Tiranë më 1981 e për rreth dhjetë vjet, punon thjeshtë si Zyre Kulturore e Ambasadës Italiane.

Në këtë periudhë operon në fushën e kulturës në mënyrë të kufizuar, duke mbajtur raporte gati ekskluzivisht me Departamentin e Kulturës dhe Ministrinë së Jashtme të Shqipërisë. Zyra përveç organizimit të ekspozitave të ndryshme, është kujdesur për kurset e gjuhës italiane për studentët shqiptar, regjistrimet e tyre në universitetet italiane, dhënia e titujve akademik dhe bursave të studimit, etj. Kurset nëpër vite, aktiviteti i institutit ka ardhur gjithmonë e në rritje, jo vetëm për aktivitetin akademik, por edhe në fushën e organizimit të ngjarjeve, deri më 1999, vit në të cilin nga thjeshtë zyrë e ambasadës ka marrë funksionet të një Instituti të Kulturës të vërtetë, me qendrën e saj

Giornata della Memoria - Projektim filmash Rosenstrasse i Margarethe von Trotta

Në vijim të këtij muaji, Instituti Italian i Kulturës në Tiranë, në bashkëpunim me Departamentin e Italianistikës të Universitetit të Tiranës, do të përkujtojë "Giornata della Memoria", dita zyrtare e rrëzimit të dyerve të burgjeve të Auschwitz – it), duke pasur si qëllim pjesëmarrjen e gjerë të studentëve. Kujtimi i masakrës dhe persekutimeve të popullit çifut e të dënuarve të kampeve naziste do të mbahet gjallë me një seri filmash, që do të projektohen pranë Spazio culturale italiano të Departamentit të Italianistikës së Universitetit të Tiranës. Rosenstrasse i Margarethe von Trotta – New York, 2001: Hannah niset për në Berlin, për të kuptuar origjinën e ortodoksisë çifute të nënës së saj, që do të ndalojë martesën e tij. Atje takon Lenën e vjetër, që i tregon

Written by Gazeta SOT

Friday, 06 February 2009 01:16 -

ngjarjet vitit 1943 në të cilën kishte përfshirë: qindra gra çifute protestonin kundër internimit të burrave të tyre...